

Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik

Bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe Ligjin për të drejtën e informimit, çdo qytetar mund t'i drejtohet Institucionit të Prefektit të Qarkut me një kërkesë ose ankesë që lidhet me veprimtarinë e këtij të fundit.

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose email, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor i cili së bashku me të dhënat e kontaktit të Koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepet kërkuarit. Informacioni jepet pa pagesë, në të njëjtën mënyrë në të cilën është kërkuar.

Kërkesa për informim duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e kërkuarit, adresën postare/elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni, përshkrimin e informacionit, formati në të cilin preferohet si dhe çdo të dhënë tjetër që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

Ankesa mund të bëhet në formë të shkruar, me postë ose elektronike, të deklarohej verbalisht para institucionit duke u regjistruar nga ky i fundit ose në çdo formë tjetër të përshtatshme. Ankesa gjithashtu duhet të përmbajë identitetin e ankuesit, qëllimin e ankesës, adresën e ankuesit si dhe çdo të dhënë tjetër që ankuesi gjykon se mund të ndihmojë në trajtimin e ankesës.

Trajtimi i kërkesës/ankesës dhe kthimi i përgjigjes bëhet sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 10 ditë pune nga data e dorëzimit të saj.

Adresa postare: Rruga e "Kavajës", Tiranë

Adresa elektronike: prefekti@prefektitirane.gov.al